

Për:	Operatorë Ekonomik: EJONA SH.P.K. me adresë në Pejë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **21.07.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **EJONA SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre**, me Numër të prokurimit: **623-26-5378-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-026-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **EJONA SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre**, me Numër të prokurimit: **623-26-5378-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-026-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **06.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre**, me Numër të prokurimit: **623-26-5378-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-026-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **EJONA SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre**, me Numër të prokurimit: **623-26-5378-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-026-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **06.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **21.07.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimet nga Operatori Ekonomik Ankimor:

1. Kërkesa për ISO 31000:2018 – Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Riskut

Në kuadër të Kërkesës 5, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur, ndër të tjera, edhe me:

ISO 31000:2018 – Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Riskut.

Konsiderojmë se kjo kërkesë duhet të largohet nga Dosja e Tenderit, sepse është e paqartë, joproporcionale dhe kufizuese.

ISO 31000:2018 nuk është standard certifikues i sistemit të menaxhimit në formën siç janë ISO 9001, ISO 14001 apo ISO 45001. ISO 31000 është standard udhëzues për menaxhimin e riskut dhe jo një standard tipik për certifikim të detyrueshëm të Operatorit Ekonomik. Prandaj, kërkimi i një “certifikate ISO 31000:2018” si kusht eliminues krijon paqartësi për operatorët ekonomikë dhe mund të rezultojë në kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Për më tepër, objekti i kësaj kontrate është instalimi, riparimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore. Menaxhimi i riskut, nëse konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues, mund të dëshmohet përmes dokumenteve më të përshtatshme dhe më proporcionale, si:

plan i sigurisë dhe shëndetit në punë;
metodologji e realizimit të punimeve;
plan i menaxhimit të projektit;
vlerësim i riskut për punët konkrete;
procedura interne të sigurisë gjatë ekzekutimit të shërbimeve.

Kërkimi i ISO 31000:2018 si certifikatë obligative nuk është i domosdoshëm për të dëshmuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-së për realizimin e kësaj kontrate.

Prandaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kërkesa për ISO 31000:2018 të largohet nga Dosja e Tenderit.

2. Kërkesa 4.4 – Një punëtor teknik i ndërtimtarisë së lartë

Në Kërkesën 4.4 është kërkuar:

“Një (1) punëtor teknik i ndërtimtarisë së lartë, me diplomë nga Shkolla e Mesme Profesionale.”

Konsiderojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me objektin e kontratës dhe duhet të largohet ose të zëvendësohet me staf relevant për fushën e ngrohjes.

Në këtë aktivitet nuk kemi të bëjmë me ndërtim të lartë, ndërtim objektesh, konstruksione ndërtimore apo punime ndërtimore të natyrës strukturore. Të gjitha pozicionet dhe qëllimi i kontratës janë të lidhura me instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes qendrore.

Për këtë arsye, kërkimi i një punëtori teknik të ndërtimtarisë së lartë si kusht eliminues nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe nuk dëshmon kapacitet real për kryerjen e shërbimeve të kërkuara.

Një kriter i tillë mund të kufizojë konkurrencën, sepse obligon operatorët ekonomikë të angazhojnë një profil profesional që nuk është i domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Prandaj kërkohet që Kërkesa 4.4 të largohet nga Dosja e Tenderit, ose të zëvendësohet me staf teknik relevant për instalime mekanike/ngrohje qendrore.

3. Kërkesa 4.1 – Dy teknikë të Makinerisë për Ngrohje dhe Klimatizim të jenë njëkohësisht edhe saldues të certifikuar

Në Kërkesën 4.1 është kërkuar:

“Dy (2) teknik të Makinerisë për Ngrohje dhe Klimatizim, me diplomë nga Shkolla e Mesme Profesionale, me përvojë pune min. 7 vite, të jenë të certifikuar saldues me EN ISO 9606-1:2017 nga një institucion i akredituar për këto lloje certifikimesh.”

Konsiderojmë se ky kriter është i pakuptimtë në formën aktuale dhe duhet të ndryshohet, sepse nuk është e arsyeshme që të njëjtët persona të jenë njëkohësisht:

teknikë të makinerisë për ngrohje dhe klimatizim; dhe
saldues të certifikuar sipas EN ISO 9606-1:2017.

Këto janë profile të ndryshme profesionale. Tekniku i ngrohjes dhe klimatizimit merret me instalim, servisim, mirëmbajtje dhe funksionim të sistemeve HVAC/ngrohje, ndërsa salduesi është profil i veçantë profesional për punime specifike të saldimit.

Nëse gjatë realizimit të kontratës ka nevojë për saldim, atëherë kërkesa duhet të formulohet ndaras, duke kërkuar veçmas teknikët e ngrohjes dhe veçmas salduesin. Kjo do të ishte më logjike, më proporcionale dhe më e lidhur me realizimin praktik të kontratës.

Kërkesa aktuale e ngushton pa nevojë konkurrencën, sepse i detyron operatorët ekonomikë që të kenë dy teknikë HVAC që njëkohësisht të jenë edhe saldues të certifikuar, ndonëse saldimi mund të kryhet nga personel i veçantë profesional.

Prandaj kërkohet që Kërkesa 4.1 të riformulohet si vijon:

“Dy (2) teknikë të Makinerisë për Ngrohje dhe Klimatizim, me diplomë nga Shkolla e Mesme Profesionale dhe me përvojë pune relevante në fushën e ngrohjes dhe

klimatizimit; si dhe një (1) saldues i certifikuar sipas EN ISO 9606-1:2017, ose me diplomë/certifikatë përkatëse për saldim, nga një institucion/trup i akredituar për këtë lloj certifikimi.”

Ky formulim do të sigurojë që Operatori Ekonomik ka kapacitetet e nevojshme profesionale për kryerjen e kontratës, pa krijuar kufizime artificiale dhe të panevojshme për konkurrencën.

Përgjigjet në Pretendimet Ankimor nga Autoriteti Kontraktues:

Operatori Ekonomik, ka ushtruar Kërkesë për Rishqyrtim brenda afatit ligjor, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues, ka hartuar Dosjen e Tenderit në kundërshtim me parimet e Prokurimit Publik. OE pretendon shkelje të Neneve 6 (Parimi i Ekonomisë dhe Efikasitetit), 7 (Parimi i Barazisë në Trajtim/Mos-diskriminimit), 28 (Specifikimet Teknike) dhe 69 (Aftësia Teknike dhe Profesionale) të LPP-së, si dhe Nenit 25 të Rregullores Nr. 001/2022.

Sipas pretendimeve të OE, tri kritere të vendosura nga AK janë jo proporcionale dhe kufizojnë konkurrencën e lirë:

- 1. Posedimi i standardit të certifikuar ISO 31000:2018 (Menaxhimi i Riskut);**
- 2. Kërkesa për një (1) teknik të ndërtimtarisë së lartë;**
- 3. Kërkesa që dy (2) teknikë Makinerisë për Ngrohje dhe Klimatizim të jenë njëkohësisht edhe saldues të certifikuar njëkohësisht saldues të certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1:2017.**

1. Lidhur me kriterin për standardin ISO 31000:2018 (Menaxhimi i Riskut)

Operatori Ekonomik pretendon se ky standard nuk lidhet drejtpërdrejt me lëndën e kontratës dhe është e paqartë, jo proporcionale dhe kufizuese.

Komuna e Rahovecit, me rastin e vendosjes së kritereve apo kërkesave kualifikuese ka kërkuar vetëm ato kërkesat dhe dëshmitë që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit/ shiko Interpretimin Nr. 26 të dt. 09.06.2023.

Arsyetimi i AK-së: Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes qendrore në objekte publike (shkolla, spitale, dhe administratë komunale) përfshin pajisje nën presion të lartë, temperaturë të lartë dhe lëndë djegëse. Çdo gabim operativ apo dështim i sistemit bart rrezik të jashtëzakonshëm për sigurinë e jetës së qytetarëve dhe integritetin e objekteve publike. Kërkesa **për ISO 31000:2018** nuk është diskriminuese pasi nuk targeton origjinën e OE-ve, por siguron që kompania e përzgjedhur ka një sistem të verifikuar institucional për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve gjatë ekzekutimit të punëve komplekse.

Duke pasur parasysh natyrën e kontratës, e cila përfshin ndërhyrje në sisteme të ndjeshme të ngrohjes qendrore në institucione publike (ku rreziqet nga dështimi i sistemit, eksplodimet apo rrjedhjet janë të larta), ky standard garanton që OE aplikon procedura strikte për parandalimin dhe menaxhimin e risqeve operative. Kjo kërkesë është proporcionale me rëndësinë e sigurisë publike dhe objektit të kontratës.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik lidhur me largimin e Certifikatës ISO 31000:2018 (Menaxhimi i Riskut), **refuzohet si i pabazuar.**

2. Lidhur me kërkesën për një (1) Punëtor Teknik të Ndërtimtarisë së Lartë

Pretendimi i OE: Operatori pretendon se kriteri nuk lidhet me objektin e kontratës, pasi qëllimi është instalimi mekanik dhe jo ndërtimi i objekteve të larta.

Arsyetimi i AK-së: Instalimi i sistemeve të ngrohjes qendrore nuk përfshin vetëm vendosjen e pajisjeve mekanike, por kërkon ndërhyrje masive të natyrës ndërtimore në strukturën e objekteve publike ekzistuese. Kjo përfshin: shpime të mureve mbajtëse, kalimin e gypave nëpër pllaka të betonit të armuar, punime të mbylljes dhe izolimit termik/akustik të kanaleve, si dhe sigurimin e statikës së dysHEMEVE ku vendosen kaldajat e rënda dhe stabilimentet përcjellëse. Prania e një **Punëtori Teknik** të ndërtimtarisë së lartë është kërkesë proporcionale për të garantuar që punimet ndërtimore/sanuese përcjellëse ekzekutohen pa cenuar stabilitetin statik të ndërtesave. Kjo kërkesë parandalon dëmtimet strukturore dhe është tërësisht në përputhje me aktivitetin e prokurimit.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik, **refuzohet si i pabazuar**.

3. Lidhur me kriterin që dy (2) teknikë Makinerisë për Ngrohje dhe Klimatizim të jenë njëkohësisht edhe saldues të certifikuar njëkohësisht saldues të certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1:2017.

Arsyetimi i AK-së: Autoriteti Kontraktues ka specifikuar këtë kriter duke u bazuar në parimin e efikasitetit dhe operimit në situata emergjente (Neni 6 i LPP-së). Kontrata përfshin "riparimin dhe mirëmbajtjen". Gjatë defekteve gjatë stinës së dimrit, koha e reagimit duhet të jetë imediate. Nëse tekniku që bën diagnostikimin e rrjedhjes ose avarisë nuk ka aftësi të certifikuara të saldimit, procesi i riparimit do të bllokohej duke pritur ardhjen e një salduesi të jashtëm, gjë që do të linte institucionet pa ngrohje për orë ose ditë të tëra. Kombinimi i certifikimit **EN ISO 9606-1:2017** me diplomën e shkollës së mesme teknike (makineri/HVAC) është një kualifikim standard dhe shumë i përhapur në tregun e punës në Kosovë. Ky kriter nuk është krijuar për të favorizuar asnjë operator specifik, por për të siguruar që personeli kyç në vend punishte ka kapacitet të dyfishtë (diagnostikues dhe ekzekutues) për të kryer punë cilësore nën presion, pa krijuar vonesa dhe kosto shtesë operative për AK-në.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik, **refuzohet si i pabazuar**.

Përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat e tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmive është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave**

dhe dëshmime mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Kërkesa janë absolutisht të domosdoshme për të konfirmuar nëse Operatori Ekonomik potencial, ka kapacitetin e nevojshme teknik dhe profesional për të realizuar këtë projekt me sukses, në mënyrë efikase dhe efektive.

Këto kërkesat/dëshmitë kanë qenë të monitoruara nga KRPP Departamenti i Monitorimit, ku neve si Autoritet Kontraktues nuk na është dhënë ndonjë vërejtjeje për të larguar nga Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit ndonjë kërkesë, përveç se të konstatojmë se të njëjtat janë të nevojshme dhe në përputhje me kontratën, për të cilat kemi dhënë arsyet dhe argumentet tona.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>